

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

REFERENC-Ë:	Numër: 02-07/25
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATE/A	29.08.2025
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së tetë (08) të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 29.08.2025, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Shpejtim Gacaferi: i cili në fillim përshëndeti, nënkryetarin e Komunës së Junikut z.Besart Tofaj, drejtorët e drejtorive komunale, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit me pas konstatoi se mbledhje marin pjesë të 10 anëtarët e kuvendit. Në mbledhje nga drejtorët prezent ishin: znj.Leonora Shehu AD,znj.Vjollca Qestaj-DBF,z.Jetmir Jasiqi-DEZH, z.Zenun Shala DUKM, z.Fatos Shala-DSHMS, z.Demokrat Ganijaj-DSHPMSI.

Anëtarët prezent

- | | |
|---------------------------------------|--------------------------------------|
| 1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK | 10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK |
| 2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK | 11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK |
| 3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK | 12. Festina Maloku - Anëtare, AAK |
| 4. Mursel Salihaj-Anëtar,LDK | 13. Lulzim Gacaferi- Anëtar, LVV |
| 5. Ermelinda Lllolluni - Anëtare, LDK | 14. Eliza Pepshi-Anëtare,LVV |
| 6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK | 15. Xhemë Tofaj-Anëtar LVV |
| 7. Leonard Lllolluni - Anëtar, AAK | |
| 8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK | |
| 9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK | |

Rendi i ditës i paraparë

1. Arsytimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara,
3. Rishqyrtimi i Vendimit nr:02-180/4898 për zgjerimin e zonës urbane në Komunën e Junikut, miratua nga Kuvendi Komunal i Junikut, datë 27.06.2025,
4. Informatë rreth përgaditjeve për fillimin e vitit të ri shkollor 2025-2026,
5. Raport mbi fushatën e korrje-shirjeve në Komunën e Junikut,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i planit Ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave.
7. Miratimi i Deklaratës për Eliminimin e të gjitha Formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike,
8. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit, dhe
9. Të ndryshme

z.Leonard Lolluni, përshëndetje për të gjithë, kryesues unë për pikën e tretë (3) nuk kam material.

z.Shpejtim Gacaferi, këtë pikë e kemi shqyrtuar edhe në mbledhjen e kaluar, por sido qoftë materialin jau sjelli kur te vimë te ajo pikë, e qes në votim rendin e ditës me pikën shtesë, kush është për? për 9 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se rendi i ditës u miratua.

1. Arsytimi i mungesave në mbledhje,

Për këtë mbledhje munguan: z.Zenel Maloku-AAK, znj.Lirjeta Shehu-LDK, z.Alfred Gaxherri-LDK, z.Lulzim Gacaferi-LVV dhe z.Xhemë Tofaj-LVV, ndërsa znj.Festina Maloku pritet të vijë në mbledhje.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara,

z.Shpejtim Gacaferi, për mbledhjen e sotit i kemi në shqyrtim tri (3) procesverbale të muajve Maj, Qershor dhe Korrik, kërkesë nuk ka e qes në votim procesverbalin e Maj-2025, kush është për? për 9 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, e qes në votim procesverbalin e Qershorit-2025, kush është për, për 9 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, e qes në votim procesverbalin e Korrikut-2025, kush është për? për 9 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se procesverbalet për Maj, Qershor dhe Korrik 2025 u miratuan.

Gjatë përgaditjes së materialit për pikën e tretë të rendit të ditës në sallë arrin edhe znj.Festina Maloku, dhe tani në sallën e kuvendit janë prezent 10 anëtarët e kuvendit.

3. Rishqyrtimi i Vendimit nr:02-180/4898 për zgjerimin e zonës urbane në Komunën e Junikut, miratua nga Kuvendi Komunal i Junikut, datë 27.06.2025,

Aryetimin e rishqyrtimit te vendimit me nr.02-180/4898 e beri z.Shpejtim Gacaferi, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Komunës se Junikut. Kerkersë nuk ka, e qes ne votim rishqyrtimin e Vendimit, kush është për? për 10 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se rishqyrtimi i vendimit me nr.02-180/4898 u miratua.

4. Informatë rreth përgaditjeve për fillimin e vitit të ri shkollor 2025-2026,

Informatën e beri z.Xhavit Velijaj- drejtor ne DAKRS i cili fillimisht i përshëndeti te gjithë me pas informoi kuvendin lidhur me fillimin e vitit të ri shkollor 2025-2026.

z.Shpejtim Gacaferi, kerkersë nuk ka, kalojmë ne pikën e radhës së ditës.

5. Raport mbi fushatën e korrje-shirjeve në Komunën e Junikut,

Informatën e beri z.Besart Tofaj- nënkryetar i Komunës së Junikut, si kryesues i komisionit për korrje-shirje ne komunën e Junikut, cili fillimisht i përshëndeti të gjithë më pas informoi kuvendin lidhur me korrje-shirjet në komunën e e Junikut.

z.Shpejtim Gacaferi-pyetje nuk ka kalojmë në pikën e radhes të ditës.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i planit Ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave

Shqyrtimin dhe arsyetimin e planit ndërkomunale të menaxhimit të mbeturinave e bëri z.Demokrat Ganiqaj-drejtor në DSHPMSI i cili fillimisht i përshëndeti të gjithë me pas e arsyetoi planin ndërkomunal për menaxhimin e mbeturinave para anëtarëve të kuvendit.

z.Shpejtim Gacaferi, pyetje nuk ka, e qes në votim planin ndërkomunal për menaxhimin e mbeturinave, kush është për? për 10 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se plani ndërkomunal per menaxhimin e mbeturinave u miratua.

7. Miratimi i Deklaratës per Eliminimin e te gjitha Formave te Dhunës ndaj Grave në politike dhe në jetën publike,

Shqyrtimin dhe arsyetimin e kësaj deklarate e bëri Kryesuesi i Kuvendit z.Shpejtim Gacaferi, meqë nuk pati asnjë pyetje rreth kësaj deklarate, e qes në votim kush është për? për 10 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se kjo deklarate u miratua edhe nga Kuvendi i Komunës së Junikut.

8. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit

Pyetje nuk pati


9. Të ndryshme

Nuk pati asnjë çështje.

z.Shpejtim Gacaferi e shpalli te mbyllur mbledhjen e Gushtit-2025

Procesmbajtësi:

z. Esat Hoxha

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Esat Hoxha', written over a horizontal line.

Kryesuesi i Kuvendit:

z. Shpejtim Gacaferi

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Shpejtim Gacaferi', written over a horizontal line.